

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Fejzullah Rexhepi dhe Nora Bllaca- Dula , si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses N.T.J "NN", me seli në Prishtinë, tani nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP), kundër të paditurës D.P.Z. "NN.1." me seli në Prishtinë me pronar L.D., për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.897/2006 i datës 20.10.2016, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 28.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës D.P.Z. "NN.1." me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.897/2006 i datës 20.10.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar, në pikën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses tani nën menaxhim të AKP-së me seli në Prishtinë dhe është detyruar e paditura që paditëses në emër të borxhit për qira, ti paguaj detyrimet e pa paguara për periudhën kohore nga data 30.05.2005 deri me datë 01.12.2005 shumën prej 3.726,00 € me kamatë të cilën e paguajnë bankat si për mjetet e deponuara në afat prej 1 viti, pa destinim të caktuar duke filluar nga data 20.10.2016 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm . Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës .

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurës në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit ose lëndën të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim .

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në procedurën e provave ka bërë shqimin e kontratave 08.12.2004 specifikacionin e faturave të pa paguara të datës 21.04.2006 dhe shkresën informuese të datës 02.01.2006 dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar pasi që nga specifikacioni i faturave të pa paguara të datës 21.04.2006, me numra të cekur si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka gjetur se për periudhën kohore nga data 03.05.2005 deri me datë 01.12.2005 secila faturë përmban shumën e qerasë mujore në vlerë prej 465,75 €, në bazë të kontratës mbi qiranë, apo në shumë të përgjithshme të borxhit prej 3.726,00 €, shumë e cila kërkohet në kërkesëpadi, e në mbështetje të provave të cekura më lartë e konformë dispozitave të nenit 262 par.1 dhe 277 par.1 të LMD-së si dhe dispozitës së nenit 450 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit .

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozitat ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditurës, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195.1 nën d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4896/2016 më dt. 28.08.2018

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

Ac.nr.4896/2016

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt.28.08.2018, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 140.1 të LPK-së.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:

Anëtarët e kolegjit

Fejzullah Rexhepi

1. _____

Nora Bllaca-Dula

2. _____

Kryetari i kolegjit

Ramë Hyseni

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 09.02.2015, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:**Anëtarët e kolegjit****Kryetar i kolegjit**

1. _____

2. _____